



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
REKTORATI

Nr 80 Prot.

Gjirokastrë më, 17.01.2025

V E N D I M

Nr. 01, datë 17, 01, 2025

P Ë R

MIRATIMIN E KRITEREVE TË PRANIMIT, NË PROGRAMIN E PËRBASHKËT ME
UNIVERSITETIN E MAQEDONISË PERËNDIMORE, NË CIKILIN E TRETË
DOKTORATË NË EDUKIM DHE SHKENCA HUMANE PRANË UNIVERSITETIN
"EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

Mbështetur në Ligiin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 39, neni 40, Statuti të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë neni 22, e neni 23, Rregullores së Ugj-së neni 11, Urdhërit nr. 362 prot, datë 12.07.2024 i MAS, Vendimit nr. 01 prot, datë 16.01.2025 dërguar me shkresën përcjellëse nr. 05/1 prot, datë 16.01.2025, në mbledhjen e datës 17.01.2025 Rektorati:

V E N D O S I :

1. Miratimin e kriterëve të pranimit, në programin e përbashkët me Universitetin e Maqedonisë Perëndimore, në ciklin e tretë Doktoratë në Edukim dhe Shkenca Humane pranë Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë për vitin 2024-2025, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Miratimin e kuotave të pranimit në programin e përbashkët 10 (dhjetë) pranime, referuar dosjes së aplikimit të miratuar me urdhër nr.362, datë 12.07.2024.
3. Vendimi i përcillet Senatit Akademik për procedura të mëtejshme.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë.

REKTORI

PROF. DR JAHOR CANA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
REKTORATI

Nr. 01 Prot.

Gjirokastrë më, 17.01.2025

V E N D I M

Nr. 02, datë 17, 01, 2025

P Ë R

KRIJIMIN E KOMITETIT SHKENCOR NË RANG UNIVERSITETI PËR FILLIMIN E
PROCESIT TË HAPJES SË SHKOLLËS DOKTORALE PRANË UNIVERSITETIT
"EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

Mbështetur në Ligiin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 39, neni 40, VKM Nr. 112, datë 23.02.2018 "Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore 'Doktor' dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë "Profesor i Asociuar" dhe "Profesor", i ndryshuar, Kreu V, pika 1, Rektorati në mbledhjen e datës 17.01.2025,

V E N D O S I :

1. Të krijojë komitetin shkencor në rang universiteti si pjesë e procedurës për hapjen e shkollës doktorale.
2. Vendimi i përcillet Senatit Akademik për procedura të mëtejshme

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë.

REKTORI

PROF. DR JAHO CANA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR
REKTORATI

Nr 207 Prot.

Gjirokastrë, më 06.02/2025

V E N D I M

Nr. 03 , datë 06.02. 2025

**PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS SË PËRGJITHSHME TË UGJ-SË
DHE NUMURIN E PERSONELIT NË TË GJITHA NIVELET**

Në mbështetje të ligjit 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 40 pika 4; të Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej", neni 23 pika 2/C; Rektorati i Universitetit "Eqrem Çabej, në mbledhjen e tij të datës, 06.02.2025,

V E N D O S I

1. Të miratojë strukturën e përgjithshme të UGJ-së;
2. Të miratojë numurin e personelit të UGJ-së në të gjitha nivelet;
3. Struktura e përgjithshme të UGJ-së dhe numurin e personelit të UGJ-së në të gjitha nivelet i bashkëlidhet këtij vendimi;
4. Ky vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe i përcillet Senatit Akademik për miratim.

REKTORI

Prof. dr. Jaho CANA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR
REKTORATI

Nr. 208 Prot.

Gjirokastrë, më 06/02/2025

VENDIM

Nr. 04, datë 06.02. 2025

PËR MIRATIMIN E RAPORTIT FINANCIAR PËR VITIN 2024 DHE DETAJIMIN E
BUXHETIT PËR VITIN 2025

Në zbatim të ligjit 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 40, pika 4; Statutit të universitetit "Eqrem Çabej", neni 23 pika 2/f; si dhe shkresës së Administratorit nr.197 Prot., datë 05.02.2025 dhe nr.198 Prot., datë 05.02.2025; Rektorati i Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, në mbledhjen e tij të datës 06.02.2025,

VENDOSI

Të miratojë:

1. Raportin vjetor financiar për vitin 2024;
2. Detajimin e buxhetit për vitin 2025;
3. Ky vendim i përcillet Senatit Akademik për miratim.

REKTORI

Prof. dr. Jahor CANA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
REKTORATI

Nr 863 Prot.

Gjirokastrë më, 24.05.2025

V E N D I M

Nr. 05, datë 24, 05, 2025

P Ë R

**PËRCAKTIMIN E TRAJTIMIT FINANCIAR TË PERSONELIT AKADEMIK NË
POZICIONIN "DOCENT" ME GRADË SHKENCORE DOKTOR (DOC. DR.)**

Rektorati i Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, i mbledhur më datë, në përputhje me Ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar neni 36, pika 5, neni 40; Statutin e Universitetit "Eqrem Çabej" neni 22, Rregulloren e Brendshme të Universitetit neni 16, Kërkesën e paraqitur nga Doc. Dr Etleva Peta si dhe duke parë nevojën për garantimin e një trajtimi të drejtë financiar për personelin akademik që zotëron titullin "Docent" dhe gradën shkencore "Doktor" (Doc. Dr.), në përputhje me nivelin e përgjegjësisë dhe kontributit akademik,

VENDOSI:

1. Personeli akademik i Universitetit "Eqrem Çabej", i pajisur me titullin "Docent" dhe gradën shkencore "Doktor" (Doc. Dr.), i cili është i punësuar me kohë të plotë në institucion, do të trajtohet financiarisht në nivelin e pagës mujore të Profesorit të Asociuar.
2. Ky Vendim njeh trajtimin financiar të barabartë për personelin me titull "Docent" dhe gradë "Doktor" pavarësisht pozicionit formal "Lektor", duke respektuar statusin dhe përgjegjësitë reale akademike në përputhje me ligjin dhe rregulloret e institucionit.
3. Vendimi të dërgohet në Senatin Akademik për miratim për të filluar efektet financiare nga data 01.06.2025

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

REKTOR

PROF. DR JAHOCANA

